



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTORI

Nr. 420/p Prot.

Tiranë, më 24.04.2023

URDHËR
NR. 29/p, DATË 24/04/2023

MBI

**“PAGESËN E TARIFËS SË STUDIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË TRETË
“DOKTORATË NË MUZIKOLOGJI” NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 39 dhe 77 e në vijim të tij, në pikën t, të nenit 27 të Statutit të Universitetit të Arteve, në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III Për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në Njësinë Bazë të KMDP-së në Fakultetin e Muzikës,

URDHËROJ:

1. PAGESA e tarifës së studimit për ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë në Muzikologji” do të paguhet sipas afateve dhe masave të parashikuara në nenin 22 të Rregullores së Programit të Studimeve të Ciklit III Për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në Muzikologji në Njësinë Bazë të KMDP-së në Fakultetin e Muzikës.
2. PAGESA do të bëhet pranë Credins Bank me faturën për arkëtim të publikuar në faqen e web-it të UART/ www.uart.edu.al.
3. Mandatpagesa do të dorëzohet nga studenti pranë zyrës së financës dhe një kopje i përcillet Fakultetit.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri Administratori i UART, Fakulteti i Muzikës dhe DBNJI-P/A.
5. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare Web të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


Prof. Kastriot CAUSHI
REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE